

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI  
TE KUFIZUAR "Besi Construzione " SH.P.K.**

Sot me date 12.01.2017 me cilesine e ortakut themelues si me poshte :

**1- Z. BESMIR SHEHAJ** , shtetas shqiptar , I datelindjes 02/05/1986 lindur ne Sturm Fier dhe banues ne Fier , madhor , me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar , identifikuar me karten e identitetit shqiptare me nr.personal : I 60502039 R

Bazuar ne Ligjin Nr. 9901 , dt. 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" , Ligjin Nr. 9723 Dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" , sot me dt. 12.01.2017 , hartojme kete Akt-Themelimi te shoqerise tregtare si me poshte vijon :

Me neneshkrimin e ketij Akt - Themelimi te shoqerise tregtare , ne nenshkruesit dhe themeluesit e saj marrim persiper te realizojme e te respektojme te drejtat dhe detyrimet me precizimet e meposhtme :

**NENI 1**

Te formojme Shoqerine Tregtare me pergjegjesi te kufizuar qe mban emrin " **Besi Construzione " SH.P.K.**

**NENI 2**

Shoqeria Tregtare " **Besi Construzione " SH.P.K.** , ka formen e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar.

**NENI 3**

3.1. Fier Fier FIER Lagjia 16 Prilli, rruga Ramiz Aranitasi, pallati 9 katesh me nr 16 kati i pare.

3.2.Ndryshimi i selise qendrore te shoqerise mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakut te Shoqerise.

**NENI 4**

Kohezgjatja e shoqerise parashikohet te jete mbi 10 vjet ,por ky afat mund te nderpritet apo te zgjatet me tej ,gjithmone ne funksion te kompetencave te ortakeve themelues te shoqerise .

**NENI 5**

Si rregull aktiviteti i shoqerise mund te zhvillohet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ,por ai mund te ushtrohet dhe jashte ketij territori ,me hapjen e filialeve apo nepermjet veprimtarive te tjera te karakterit tregetar.



#### NENI 6

Themeluesi i Shoqerise "**Besi Construzione**" SH.P.K. me kete akt- themelimi , merr persiper qe te respektojne te gjitha detyrimet qe parashikon legjislacioni tregtar e civil shqiptar per shoqerite tregtare me pergjithesi te kufizuar , si dhe ti permbahet kriterit te respektimit te politikës tregtare qe zhvillohet sot ne Republikën e Shqiperise.

#### NENI 7

7.1. Kapitali themeltar i Shoqerise "**Besi Construzione**" SH.P.K. ne momentin fillestar te krijimit eshte 100,000.00 (njqind mije) leke, i gjithi i nenshkruar dhe i shlyer prej ortakeve .

Me legalizimin e Shoqerise ne organet kompetente te shtetit Shqiptar dhe me fillimin e ushtrimit te aktivitetit te saj , kapitali Themeltar i kesaj shoqerise mund te zmadhohet .

7.2. Ortaku I vetem ka kontribuar dhe zoteron ne kapitalin e shoqerise kuotat si me poshte :

**1- Z. Besmir Shehaj** , eshte zoterues i nje kuote prej **100% te kapitalit themelues** te shoqerise ose i shprehur ne vleren e kapitalit themeltar 100,000.00 leke( njqind mije lek), shume e cila do te depozitohet pas krijimit te shoqerise ne llogarine bankare qe do te hapi shoqeria .

#### NENI 8

Shoqeria "**Besi Construzione**" SH.P.K ashtu sikurse eshte parashikuar ne Aktin Themelues te Shoqerise , aktiviteti i saj kryesor i veprimtarise do te jete :

"Punime ndertimi te ndryshme si: Murator, formim armature, punime hidraulike, punime elektrike perpunim hekuri punime per lyerje te ndryshme me boje etj. Import-Eksport materiale, mallra, makineri e paisje ne fushen e ndertimit dhe ne industri te tjera etj. Sherbime te ndryshme komisionere."

#### NENI 9

**Organet drejtuese te shoqerise jane :**

1 – Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve .

2 – Administratori.

Detyrat e organeve drejtuese te shoqerise do te percaktohen ne Statutin e shoqerise.

#### NENI 10

Ortaku i vetem themelues i shoqerise ka vendosur qe si **administrator** i Shoqerise" "**Besi Construzione**" SH.P.K. do te jete **Z. Besmir SHEHAJ**.

Ai pergjigjet mbi bazen e kompetencave te tij te percaktuara ne Statutin e shoqerise . Gjithashtu ai merr persiper se do konfirmoje emrat e ortakeve qe mund te shtohen ,pjeset e kapitalit themeltar si dhe shumen e derdhur nga secili prej tyre.



Gjithashtu ai pergjigjet per administrimin e vlerave pasurore te Shoqerise , te cdo natyre qofshin ,te shlyeje detyrimet qe ka Shoqeria me te tretat Brenda vleres se kapitalit ,te beje mbi bazen e kontributeve te dhena shperndarjen e fitimit.

Si organ ekzekutiv i Shoqerise ,te drejttat dhe detyrat e administratorit ,rregullohen me aktet themeluese te Shoqerise ,Statutin e Shoqerise si dhe aktet e tjera normative te nxjerra nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve apo dhe me marreveshje te vecanta.

#### NENI 11

Mandati i Administratorit , per administrimin ne kete shoqeri ,eshte **per nje periudhe 5 vjet me te drejte ripertitje .**

Administratori apo ai qe i delegohet ky pushtet ,ka te gjitha kompetencat te cilat ai deklarohet se i njeh dhe i pranon ,per te kryer te gjitha detyrimet qe i lindin ne baze te statutit te Shoqerise , sikurse parashikohet ne legjidslacionin e Shtetit shqiptar dhe ne menyre te vecante ne "Tre Ligjet per Shoqerite Tregtare ".

#### NENI 12

Ortaket ,administratori dhe punonjesit e shoqerise "**Besi Construzione "** SH.P.K. pergjigjen ndaj shoqerise per demin e shkaktuar nga perhapja e sekreteve tregtare , per te cilat kane dijeni , per shkak te kryerjes se funksioneve te tyre ne shoqeri.

#### NENI 13

Te gjitha mosmarreveshjet midis ortakeve duhet te zgjidhen me mirekuptim . Ne rastet kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim secili prej ortakeve ka te drejte ti drejtohet per zgjidhje Gjykates kompetente.

#### NENI 14

Ortaku themelues i shoqerise deklarohet se njeh te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga ky Akt – themelim i Shoqerise "**Besi Construzione "** SH.P.K dhe me vullnet te lire e firmosin ate .

**Ky Akt-Themelimi perpilohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen shqipe , te gjitha me te njejten vlere ligjore.**

**PER SHOQERINE "Besi Construzione " SH.P.K  
ORTAKU THEMELUES**

1) – Z. Besmir SHEHAJ

